AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 2519/1 Prot
Datë 13.08.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE KAMËZ**

Nr. 477 prot. Data. 10. 08. 2021

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**
**DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**
**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë .27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin ...:
- Një mësimdhënës për lëndët profesionale Drejtimi mësimor TIK .

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:
- të ketë diplomë të nivelit master profesionalose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

**2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
a) - letërmotivimin për pozicionin;
b) - jetëshkrimin (CV-në);
c) - kartën e identitetit;
d) - diplomën;

e) - librezën e punës;
f) - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
gj) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j) - vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.
- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës ..20.08.2021

DREJTOR I SHKOLLËS
Eris MARTINI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE BUJQESORE
KAMEZ
TIRANE